

**ALBANA MEMA****SITUATA NË SHQIPËRI PAS KRIZËS SË RËNDË POLITIKE  
TË VITIT 1921 DHE KRYENGRITJES SË MARSIT 1922****Grushti i shtetit i dhjetorit të vitit 1921**

Sfidat më të rënda të qeverisjes, vinin nga vetë cilësia dhe kapacitetet e klasës politike shqiptare, nëse kjo mund të cilësohet si e tillë. Kështu, në një moment delikat për shtetin shqiptar, kur ai ishte i kërcënuar seriozisht nga rebelimi antishtetëror dhe antikombëtar i prijësit të Mirditës, Marka Gjoni, u mendua krijimi i një kabineti, i cili do të mbështetej nga pozita dhe opozita dhe kishte për detyrë të stabilizonte shtetin. Kabineti i Evangjelit, që ishte krijuar me qëllimin e posaçëm të mbrojtjes së tërësisë së shtetit dhe që u njoh si “Bashkimi i Shenjtë”, përfshinte tre prijësit më të shquar guerrilas, që ishin Ahmet Zogu, Bajram Curri dhe Zija Dibra.<sup>1</sup> Por, të pakënaqur me qeverinë e Pandeli Evangjelit, nismëtarët e “Bashkimit të Shenjtë” shpejt iu vunë punës për ta rrëzuar atë, e për të vendosur pushtetin e tyre të plotë. Për t’i pasur duart më të lira, në veprimet e tyre, ata vendosën të shpërndajnë parlamentin. Më 4 nëntor, organizuan mbarimin e sesionit të Këshillit Kombëtar dhe në mënyrë të papritur, u lexua dekreti i Këshillit të Lartë, mbi shpërndarjen e parlamentit deri më 4 janar 1922, gjoja “për t’i lënë qeverisë liri veprimi në përballimin e situatës në kufirin jugosllav.” Më tej, dy anëtarët e Këshillit të Lartë, Aqif Pashë Elbasani dhe Luigj Bumçi, shkaktuan një krizë qeveritare (dy ministra dhanë dorëheqjen) dhe më 6 dhjetor 1921, vendosën të shkarkojnë qeverinë e Pandeli Evangjelit. Në fillim ai refuzoi të japë dorëheqjen, derisa të mblidhej parlamenti, por aty nga mesnata e kësaj date, nën kërcënimin me armë, pranoi për të mos dhënë shkas për gjakderdhje. Në këtë mënyrë u krye një grusht shteti.

Pra, qeveria që ishte në atë kohë në fuqi, ajo e P. Evangjelit, u rrëzua nga një grusht shteti, i pari në historinë moderne të Shqipërisë, i cili u organizua nga dy anëtarë të Këshillit të Lartë dhe nga një grup tjetër politikanësh, bërthamën e të cilëve e përbënin disa drejtues të “Komitetit të

<sup>1</sup> Joseph Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005, f. 291.

Kosovës”. Ky akt antikushtetues do të dështonte për shkak të mungesës së mbështetjes në vend, organizimit të dobët të tij, qëndresës që i bëri populli i Tiranës dhe nëpunësit e administratës shtetërore dhe ndërhyrjes së një pjese të ushtrisë. Ardhja e A. Zogut me forca në Tiranë, ishte faktori kryesor që ndihmoi për të shtypur grushtin e shtetit.

Kriza politike e dhjetorit 1921, do t’i jepte rrugë paqëndrueshmërisë së mëpasme. Këto ngjarje dëshmonin kapacitetet tepër të ulëta institucionale dhe qeverisëse të Shqipërisë në këtë kohë dhe mentalitetin e rrezikshëm të elitës drejtuese, në raport me shtetin dhe stabilizimin e tij. Pra, ishte lehtësisht e kuptueshme se Këshilli i Lartë nuk mund të qëndronte si organ i pavarur dhe si arbitër në lojën parlamentare të partive. Madje, jo vetëm kaq por, ai mori edhe një nisëm të rrezikshme si për stabilitetin e vendit dhe ndërtesën e tij shtetërore ashtu edhe për vetë autoritetin dhe vijueshmërinë konstitucionale të tij. Me grushtin e shtetit të dhjetorit 1921, jo vetëm që u ndërpre procesi normal i qeverisjes së vendit në rrugë ligjore por, u krijua një precedent i rëndë negativ në procesin e ecurisë së shtetit ligjor.

Rrëzimi i kabinetit të kryesuar nga P. Evangjeli, pati impakt edhe në jetën shoqërore në vend. Mënyra e rrëzimit të tij nga Këshilli i Lartë, e zemëroi popullin dhe opinioni publik në vend, e konsideronte këtë akt, një veprim arbitrar që ishte në kundërshtim të hapur me Statutin e Lushnjes. Duke e denoncuar grushtin e shtetit, gazeta “Dielli” shkruante: “Sjellja e Regjencës që shtrëngoje z. Pandeli Evangjeli dhe kabinetin e tij të japë demicjen e zemëroj keq popullin, i cili e quan këtë punë si shkelje të shtetit të Lushnjes. Korça, Berati, Elbasani, Durrësi, Gjirokastra dhe Vlora protestuan”.<sup>2</sup>

Lidhur me grushtin e shtetit të dhjetorit të vitit 1921, ka pasur pikëpamje të ndryshme në historiografi. Në botimin shkencor “Historia e Popullit Shqiptar” (v. III, botim i Akademisë së Shkencave, Instituti i Historisë, 2007), ajo përcaktohet thjesht si krizë e shkaktuar nga pakënaqësia dhe shqetësimi i kundërshtarëve të A. Zogut, për forcimin e pozitave të tij në “Partinë Popullore” dhe në qeveri dhe nuk është përmendur asnjëherë termi “grusht shteti”. Sipas këtij botimi: “Acarimi i kontradiktave të brendshme çoi në dhjetor 1921 në një krizë politike të thellë, që ndikoi në tronditjen e qeverisjes së vendit. Kriza politike u bë

<sup>2</sup> “Sjellja e Regjencës zemëroj tërë popullin në Shqipëri”, *Dielli*, nr. 2331, Boston Mass, dt. 10.01.1922.

shkak për përballjen me njëri-tjetrin të organeve më të larta të shtetit, të qeverisë, të Këshillit Kombëtar dhe të Këshillit të Lartë, në gjirin e të cilave u shfaqën ambiciet për pushtet nga figurat dhe grupimet e ndryshme politike”.<sup>3</sup>

Protestat kundër grushtit të shtetit, të cilat nuk janë përmendur nga historiografia e mëparshme, pohohen nga burime të ndryshme. Ato dëshmonin se, në vend, me gjithë pamaturinë politike dhe institucionet e dobëta, ekzistonte një bërthamë e shëndoshë e opinionit publik, e cila e kuptonte drejt rrezikshmërinë e këtyre ngjarjeve, për fatet e mëtejshme të procesit të konsolidimit të shtetit shqiptar. Ka disa studiues të kohës, si për shembull Swire apo ndonjë tjetër, që për këtë ngjarje kanë përdorur terma të moderuara, duke e cilësuar atë si një rrëzim jokushtetues të qeverisë së Evangjelit nga Këshilli i Lartë, për shkak të mosmarrëveshjeve midis tyre.<sup>4</sup> Sigurisht, në këto përcaktime kanë ndikuar dy faktorë kryesorë. Së pari, fakti që grushti i shtetit u krye pa zhurmë dhe pa gjakderdhje; së dyti, ishin mungesa e dispozitave të qarta ligjore dhe e kompetencave të përcaktuara nga legjislacioni dhe pikërisht nga dokumenti themeltar “Bazat e Kanunores”, që krijonte paqartësi dhe ngatërresa. Megjithatë, logjika e thjeshtë e krijimit dhe e rrëzimit të qeverive përmes votëbesimit në parlament e bënte këtë një veprim jo ligjor dhe i jepte trajtën e një grushti shteti.

Nëse këto ngjarje do t'i gjykojmë nga pikëpamja juridike do të shohim se dekreti i Këshillit të Lartë mbi “pushimin nga puna” të P. Evangjelit është në kundërshtim të plotë me Statutin e Lushnjes dhe për pasojë, tërësisht i paligjshëm. Nga shqyrtimi dhe analiza e dispozitave të Statutit të Lushnjes shihet se Këshilli i Lartë nuk ka të drejtë të rrëzojë një kabinet që ka marrë votëbesimin e Parlamentit. Sipas Statutit, Këshilli i Lartë emëron kryeministrin, por ky i fundit nuk mund të fillojë nga puna pa marrë votëbesimin e Parlamentit. Gjithashtu Statuti përcakton se deri në marrjen e votëbesimit nga qeveria e re në Parlament, në fuqi qëndron kabineti i mëparshëm. Pra, Statuti i jep të drejtë Këshillit të Lartë të emërojë kryeministrin dhe jo ta shkarkojë atë. Sipas tij, dy janë mënyrat e ndryshimit të qeverisë: rrëzimi i saj nga Parlamenti dhe dorëheqja e vetë kryeministrit.

<sup>3</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, v. III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 181.

<sup>4</sup> J. Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie .....*, f. 302.

### **Qëndrimi i Parlamentit përballë grushtit të shtetit të dhjetorit 1921**

Grushti i shtetit të dhjetorit të vitit 1921 do të vinte në provë edhe një institucion tjetër të lartë si dhe dominimin e tij mbi Këshillin e Lartë. Tashmë pritej të provohej fuqia e një organi themelor ligjvënës, siç ishte parlamenti, i cili ishte gjendur para një grushti shteti të paprovokuar dhe tërësisht të pajustificueshëm. Qëndrimi i tij, do të ndikonte shumë në forcimin e legjitimitetit dhe të institucioneve shtetërore në të ardhmen ose do të ndodhte e kundërta, në se nuk do të mbahej qëndrimi i duhur ligjor, do t'u hapej rruga anarkisë dhe krizave të tjera edhe më të rrezikshme politike dhe institucionale. Ky moment ishte shumë i rëndësishëm, për të provuar nëse klasa politike drejtuese e vendit, do të tregojë aftë të dilte mbi kufizimet dhe interesat e saj dhe të vinte në plan të parë forcimin e institucioneve dhe vijueshmërinë normale të shtetit. Në të vërtetë, qëndrimi i saj shërbeu vetëm për ta shtyrë krizën dhe për t'i dhënë vendit një qetësi të përkohshme.

Pasi në krye të komplotit qëndronin dy anëtarë të Këshillit të Lartë, Aqif Pasha me Imzot Bumçin, parlamenti vendosi shkarkimin e tyre, duke i zëvendësuar këta me Ymer Pashë Vrionin dhe me Ndoc Pistulin. Me dekretin e tij, nr. 743, datë 23.12.1921, Këshilli Kombëtar njoftoi shkarkimin e dy anëtarëve të Këshillit të Lartë, por, pa përcaktuar arsyet e një vendimi të tillë. Këto arsye thuhej se do t'i njoftoheshin popullit me një deklaratë të posaçme.<sup>5</sup> Dy anëtarët e tjerë të regjencës, Abdi Toptani dhe dr. Turtulli, mbasi e konsideruan rrëzimin e dy kolegëve të tyre, një shkelje të Statutit të Lushnjës, dhanë dorëheqjen.<sup>6</sup> Në vend të tyre, parlamenti zgjodhi Refik Toptanin dhe Sotir Pecin. Megjithatë, dorëheqja e anëtarëve të Këshillit të Lartë, ishte një reagim i çuditshëm, pasi ata i referoheshin Statutit të Lushnjës, kur dy kolegët e tyre kishin kryer një grusht shteti, një akt që vinte në kundërshtim të hapur me dispozitat e Statutit të Lushnjës dhe për më tepër, ata ishin bashkëpërgjegjës, pasi nuk kishin bërë asnjë përpjekje për ta ndaluar këtë zhvillim të rrezikshëm. Kjo ishte një provë tjetër domethënëse e kapacitetit të ulët politik dhe

<sup>5</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 152, Viti (më tej: V.) 1921, Dosja (më tej: D.) 36, fl.1, Shkresa nr. 743 më 23.XII.1921 e Këshillit Kombëtar (Eshref Frashëri) dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, mbi rrëzimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë.

<sup>6</sup> Po aty, F. 147, V. 1921, D. I-18, fl. 23, Shkresë e anëtarëve të Këshillit të Lartë, dt. 22.12.1921, ku njoftojnë kryetarin e Parlamentit për dorëheqjen e tyre.

menaxhues, të ajkës drejtuese të shtetit shqiptar, në këtë periudhë, por edhe e ndërgjegjes së tyre kushtetuese.

Zhvillimet politike të vitit 1921, bënë që autoriteti dhe pesha e institucionit të kreut të shtetit të pësonte një rënie të ndjeshme, ndërsa dominimi i Parlamentit mbi të, do të rritej. Por, ky akt i Këshillit të Lartë do të acaronte në kulm edhe marrëdhëniet midis partive politike në gjirin e parlamentit. Kështu, në mbledhjen e parë të tij, pas grushtit të shtetit, Parlamenti diskutoi mbi deputetët e Drinit. Duke marrë parasysh se në viset e prefekturës së Drinit, që u liruan nga okupacioni jugosllav nuk ishin bërë zgjedhjet parlamentare të rregullta dhe mbasi populli i asaj prefekturë kërkonte të bëheshin zgjedhje të lira, vendosi t'i rrëzojë ata nga deputetësia. Sigurisht në këtë qëndrim, ndikoi shumë angazhimi i tyre në mbështetje të grushtit të shtetit. Po në atë mbledhje, parlamenti dëgjoi nga goja e Pandeli Evangjelit ngjarjen e grushtit të shtetit. Ai tregoi se si komplotistët e kishin rrethuar banesën e tij me forca të armatosura dhe se si me frikësime për gjakderdhje e kishin detyruar atë të jepte dorëheqjen. Largimi i deputetëve të Drinit që kishin marrë pjesë në komplot, do ta nxirrte ballafaqimin politik nga Parlamenti, jashtë tij dhe do ta kthenin atë nga një ballafaqim politik brenda suazës konstitucionale, në një konflikt jashtë saj. Ai do të merrte trajtën e një konfrontimi me armë, për shkak se krerët e larguar nga parlamenti, dispononin forca paramilitare të gatshme për tu vënë nën urdhrat dhe komandën e tyre. Pra, grushti i shtetit u bë shkak edhe për krizën e parlamentit dhe parlamentarizmit në Shqipëri në këtë periudhë.

Ngjarjet e vitit 1921 dhe reagimi ligjor ndaj autorëve të grushtit të shtetit, dëshmojnë se në çfarë niveli ishte sistemi parlamentar i asaj kohe, si dhe vetë shteti ligjor. Ndonëse Parlamenti ishte i shpërndarë, ndaj këtij akti, reagues shumë deputetë, por, edhe Kryetari i Parlamentit, Eshref Frashëri, i cili, i kishte dërguar një telegram, Këshillit të Regjencës, më 9 dhjetor 1921, në të cilin bëhej e njohur se, sipas Statutit të Lushnjës, një qeveri nuk mund të qëndrojë në fuqi pa votëbesimin e parlamentit. “Kabineti i ri nuk është njohur nga përfaqësuesit e popullit”<sup>7</sup>, thuhej më tej në telegram.

Por, roli stabilizues i Parlamentit, do të evidentohet pas shtypjes së grushtit të shtetit. Në vazhdim të deklaratës së tij në Parlament, Evangjeli

<sup>7</sup> AQSH, F. 163, V. 1921, D. 16, fl.19, Telegramë mbi krizat qeveritare, Presidenti i Dhomës - Eshref Frashëri i dërgon telegram Këshillit të Regjencës, dt. 9 dhjetor 1921, mbi ngjarjet e fundit në vend.

lexoi korrespondencën që kishte pasur me anëtarët e Këshillit të Lartë. Pas kësaj Parlamenti diskutoi grushtin e shtetit duke e dënuar atë.<sup>8</sup> Për këto ngjarje dhanë mendimet e tyre edhe eksponentë të tjerë të politikës së kohës. Kështu, Mithat Frashëri, në fjalën e tij para deputetëve, deklaronte: “Kësaj i thonë Coup d’Etat (grusht shteti) d.m.th me rrëzue me forcë një Kabinet qi kishte besimin e Parlamentit dhe që kishte dhanë fjalën e nderit dhe besën për mbledhjen e Parlamentit me 4 Jenar dhe që nuk kish as ndonji shkak të mbrendshëm ose të jashtëm për një krizë të këtillë”.<sup>9</sup> Sipas M. Frashërit, vendimi i Parlamentit duhet të bazohet mbi këtë grusht shteti. “Disa prej nesh, vazhdon ai fjalën e tij, thonë se Statuti i Lushnjës nuk na ep të drejtë për rrëzimin e Këshillit të Naltë. As ndonji Statut në botë nuk përfshinë dispozicionet e posaçëm përmbi grushtin e shtetit”.<sup>10</sup> Edhe deputetë të tjerë si Leonidha Koja, Stavro Vinjau etj., dhanë opinionet e tyre për ngjarjet e ndodhura në vend.<sup>11</sup> Ky debat dhe përfundimet e tij, ishin shumë interesante për të provuar forcën e parlamentit dhe faktin se si vepronte ai në raste të tilla, duke luajtur rolin e një gjykate të lartë në vend.

Trazirat politike të dhjetorit të vitit 1921, si dhe vendimet e marra pas saj, nga parlamenti e qeveria kundër organizatorëve të grushtit të shtetit, krijuan një pakënaqësi të madhe në radhët e kundërshtarëve të Zogut. Vendimet, sado të moderuara që ishin, shërbyen si shkaqe kryengritjesh antiqeveritare. Në pamje të parë, dukej se ishte krijuar perspektiva për një opozicion të moderuar. Por, meritë e së shkuarës dhe mendësia shqiptare për hakmarrje, ishin më të fuqishme se arsyeja e nevojave të konsolidimit të shtetit.

Në fakt, duhet gjykuar me kujdes, situata në të cilën u gjendën institucionet përfaqësuese të vendit, në ato momente. Atyre iu mungonte eksperiencia, tradita ligjore dhe kapacitetet institucionale, për ta zgjidhur situatën në një mënyrë që, nga njëra anë të ruhej stabiliteti i vendit dhe në anën tjetër, të merreshin masa të tilla ligjore, të cilat të mos lejonin përsëritjen e ngjarjeve të tilla në të ardhmen.

Qëndrimi tolerant dhe jo adekuat, nga Parlamenti, i vlerësuar në këndvështrimin e zbatimit të ligjit, siç do të ishte bërë në çdo vend tjetër, ku funksiononte një shtet pak a shumë ligjor, me institucione relativisht të

<sup>8</sup> *Bisedimet e Këshillit Kombtar (BKK)*, Mbledhja e 73-të, 22 Dhetuer 1921, f. 610.

<sup>9</sup> *Po aty*.

<sup>10</sup> *Po aty*.

<sup>11</sup> *Po aty*, f. 616-621.

konsoliduara, linte të hapur gjithashtu rrugën për përsëritjen e grushteve të tjera të shtetit në të ardhmen. Dhe për fatin e keq të Shqipërisë, episode të tilla, të dhimbshme dhe të rrezikshme, nuk do të vononin të vinin. Dështimi i grushtit të shtetit, i dhjetorit të vitit 1921, eliminimi i tij pa gjakderdhje në Parlament, ishte një shans i ri që i jepej mbijetesës së sistemit parlamentar në Shqipëri. Nga ana tjetër, vetë grushti i shtetit dhe shpërndarja para tij me mendjehetësi e parlamentit, dëshmonte se sa i brishtë ishte ky institucion në Shqipëri dhe se sa të vakëta ishin shanset për forcimin dhe konsolidimin e tij në të ardhmen.

Nëse në këtë kohë, ligji do të ishte zbatuar me rigorozitet, do të ishin arritur rezultate të tjera shumë më pozitive, për konsolidimin e shtetit dhe fuqizimin e ligjit dhe të institucioneve. Por, nga ana tjetër, edhe dënimi i ashpër mund të kishte sjellë reagime më të ashpra të anarkistëve dhe atyre që organizuan grushtet e shtetit apo kryengritjet dhe kjo do të sillte një shkallë më të lartë tensioni e gjakderdhje që mund ta fusnin vendin në ciklin e një lufte civile shkatërrimtare. Se cila rrugë do të kishte qenë më e dobishme edhe sot është vështirë të jepet një përcaktim. Gjithsesi, dënimi ligjor, nëse do kishte qenë i mundur, mund të kishte krijuar modelin e respektimit të ligjit dhe institucioneve, i cili është dëshmuar, jo vetëm në këtë kohë, por edhe më vonë, se ka qenë tepër problematik për Shqipërinë.

### **Institucioni i Parlamentit nën optikën e organizmave ndërkombëtarë**

Lidhur me performancën e Parlamentit të parë Shqiptar, gjatë vitit 1921, jepet një gjykim dhe një përmbledhje interesante, nga përfaqësuesi britanik, Harry Eyres, i cili, më 1 maj 1922 shkruante: “Dhoma e Deputetëve nuk është cilësuar për ndonjë rekord në legjislacion gjatë këtij viti. Por ka zhvilluar diskutime politike, për të cilat të gjithë shqiptarët janë përgjegjës. Por, ndoshta, ishte e tepërt të shprejsoje që deputetët, të cilët ishin parlamentarë krejtësisht të rinj, do të kishin sjellë ndonjë efekt të madh, për më tepër edhe kur vendi ka qenë nën kërcënimin e luftës për gjatë gjithë gjysmës së vitit dhe çështja e kufijve akoma nuk ka përfunduar. Por, diskutimet janë zhvilluar me dinjitet dhe rregull, dhe sjellja e deputetëve krahasohet favorshëm me sjelljen edhe debatet në

Parlamentet e vendeve fqinje.”<sup>12</sup> Eyres, ndër të tjera, përmendte këto akte të këtij parlamenti, për vitin 1921: “Konfirmimi i vlefshmërisë së zgjedhjeve të kontestuara; anulimi i titujve turk të trashëguar; një ligj për përmirësimin e kushteve në burgje dhe të burgosurve; formimi i një komisioni për të projektuar një kod të ri ligjor; deklarimi i shkëputjes nga Turqia dhe pamundësia e elementëve turk për të hyrë në qeverisje; ministri i Financave u instruktua për të hapur negociatat për krijimin e një Banke Nacionale; kalimi i koncesionit të duhanit për kompaninë britanike; përcaktimi i taksave për miellin, grurin dhe misrin”.<sup>13</sup> Gjithashtu ai nënvizonte se, Parlamenti kishte qenë në sesion për një periudhë të shkurtër që nga shtatori, dhe atëherë ishin shtuar edhe vështirësitë politike. Eyres konkludonte: “Është e kuptueshme, edhe për shkak të rezymesë së ngjarjeve të bërë më sipër, se nuk ka pasur shumë mundësi për Shqipërinë të bënte një progres të madh drejt arritjes së një qeverisjeje të qëndrueshme me ideale të qytetëruara. Por, megjithatë, po ecet në këtë drejtim. Ministrat dhe Deputetët po fitojnë eksperiencë nga gabimet e tyre, dhe besnikëria e njerëzve ndaj drejtuesve historikë të tyre, po shkon drejt besnikërisë ndaj qeverisë qendrore. Atmosfera, gradualisht po ndryshon. Por, procesi është i ngadalshëm dhe mund të përfundojë me gjeneratën e re, kur në Shqipëri, do të krijohet një qeverisje konstitucionale, ku të gjitha pabarazitë e shkaktuara nga fetë dhe ndryshimet krahinore, do të lihen mënjanë.”<sup>14</sup>

Destabilizimi i vendit, gjatë dhjetorit 1921, duket se tronditi shpresën e vakët që kishin pasur më parë, përfaqësuesit britanikë, për mundësinë e funksionimit të një sistemi parlamentar në Shqipëri. Në një raport të titulluar *“Imagjinata e qeverisjes parlamentare”*, diplomati britanik Heathcote-Smith i shkruante kështu sekretarit të Jashtëm britanik: “Mendoj se nuk e ekzagjeroj po të them që të gjithë deputetët janë caktuar nga lart, votuesit në të dy kategoritë ndjekin verbërisht urdhrat e marra. Edhe në Shkodër, qendra më e shkolluar e Shqipërisë, e gjithë lista e katolikëve e përcaktuar nga liderët e partisë është ndryshuar në momentet e fundit. Me përjashtime të rralla, e gjithë dhoma e Parlamentit konsiston në të nominuar nga pak lider, të cilët kanë besimin e deputetëve

<sup>12</sup> *The British National Archives* (më tej: TNA), Foreign Office (më tej: FO) 371/7332, f. 384-394, Raport vjetor për vitin 1921, H.C.A. Eyres, Durrës, për Marquess Curzon of Kedleston, 1 maj 1922.

<sup>13</sup> *Po aty.*

<sup>14</sup> *Po aty.*

pa asnjë dyshim. Demokracia në Shqipëri është duke u ngushtuar dhe përqendrohet në Tiranë.”<sup>15</sup> Në një raport tjetër, Smith, veçonte, si një pengesë të fortë, për funksionimin normal të një sistemi parlamentar, ekzistencën e krerëve të fuqishëm, të cilët, kishin pas vetes një mbështetje të fortë ushtarake. Nën titullin: “*Fuqia e Bejlerëve*”, në këtë raport, ai shkruante: “Në sipërfaqe Shqipëria duket sikur ka liderë politikë në kuptimin demokratik, por, kjo nuk është e vërtetë. Fuqia e një lideri nuk varet nga votat, por nga pushkët. Homazhi i idealeve perëndimore të demokracisë, që ka të bëjë me respektimin e metodave parlamentare të opozicionit, për aq sa mund të jetë sukses, është i parakohshëm. Këtu dalin në pah fuqitë e armatosura, siç ishte rasti i krizës së fundit... Për sa kohë arsyet e mosmarrëveshjeve janë personale, më tepër për të marrë pushtet, sesa për të vendosur një politikë të veçantë, bashkimet dhe shpërbërjet mes liderëve e kanë të vështirë të qëndrojnë në paqe, për sa kohë që bashkimet dhe ndarjet varen nga oportunitizmi, me arritjen e postit si qëllim kryesor.”<sup>16</sup>

Pas dështimit të grushtit të shtetit, Smith analizoi me kujdes edhe situatën e krijuar dhe masat që mori shumica parlamentare. Interesant është të nënvizohet fakti se, ai parashikonte konflikte të reja pas anulimit të mandateve të deputetëve të Drinit, si dhe kritikonte masat për shkarkimin e regjentëve që kishin drejtuar grushtin e shtetit, të cilat i quante antiligjore. Smith shkruante: “Siç kam raportuar më parë, Parlamenti u mblodh dhe ‘Klika’, me anë të votave të ‘Partisë Popullore’, pas eliminimit të kundërshtarëve të tyre, duke anuluar zgjedhjet e deputetëve të Drinit (Hasan Beu dhe pasuesit e tij), morën pastaj një sërë masash ‘nacionale’”.<sup>17</sup> Smith përcaktonte edhe radhën e përgjegjësive, për sa kishte ndodhur. Ai pohonte: “Duhet të shihet se në krye të paligjshmërisë së parë, ishte veprimi i kryer nga Aqif Pasha, i cili u konsiderua se kishte vepruar *ultra vires* (përtej kompetencave), duke refuzuar të firmoste dekretet që iu paraqitën atij për ministrat e Evangjelit. Kjo u pasua nga shumë abuzime mbi regjimin e vendosur nga Statuti i Lushnjës, që në të vërtetë, krijoi një gjendje të vështirë, ngatërresë ligjore”.<sup>18</sup> Nga gjithë këto zhvillime dramatike, Smith

<sup>15</sup> TNA, FO 371/7330, f. 581-586, Telegram i Heathcote Smith për Curzon, mbi situatën politike në vend, 18 janar 1922.

<sup>16</sup> *Po aty*.

<sup>17</sup> *Po aty*.

<sup>18</sup> *Po aty*.

përcaktonte me saktësi dhe mprehtësi edhe ato që ai i quante, “pengesat në rritjen e Shqipërisë.” Ai theksonte: “Si përfundim, mund të thuhet se, mosmarrëveshjet e shumta në Shqipëri lindin nga nevoja që sjell loja në një qeverisje parlamentare të trilluar... Shqipëria, si një e tërë, nuk është akoma gati të trajtojë organizmin delikat të demokracisë kushtetuese. Një makineri e komplikuar në duart e njerëzve primitivë është e rrezikshme. Në qoftë se Shqipëria do të mbante, që në fillim, një kushtetutë demokratike me të drejta të plota dhe pa kontroll nga lart, vështirë se do të kishte më tej progres, për shkak të lirisë së tepruar.”<sup>19</sup> Pasi parashtronte këtë tablo, aspak shpresëdhënëse, për një sistem parlamentar demokratik në Shqipëri, Smith, konkludonte duke sugjeruar një sistem autokratik. Vizioni i tij për këtë sistem ishte ky: “Duke qenë aty një sovran i fortë me fuqi mbikëqyrëse të përshtatshme, duke formuar një bërthamë ushtarake nga disa mijëra njerëz të tij dhe një këshill legjislativ përfaqësues por i nominuar gjerësisht, i lidhur me autonominë lokale të provincave më të zhvilluara, siç është Shkodra, ndërsa do të ketë qëllime të shumta për energjitë dhe aktivitetet rajonale, makineria e qeverisë qendrore, do të ketë mundësi të punojë e lirë nga ndërhyrjet, për zhvillimin gradual të vendit.”<sup>20</sup> Një rrezik tjetër, që diplomati Smith shihte në horizont, ishin masat e forta apo strikte ligjore që mund të merreshin ndaj organizatorëve të grushtit të shtetit të dhjetorit 1921.<sup>21</sup>

Ngjarjet e grushtit të shtetit i komentonte edhe Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve, ndër arsytet e këtij akti ai rendiste së pari, Statutin e Lushnjës. Sipas tij, “*Me Kushtetutën e Lushnjës, fuqia ekzekutive është teorikisht në duart e katër regjentëve, që përfaqësojnë katër fetë në vend. Meqenëse fuqitë e Regjencës nuk u përcaktuan qartë në Kushtetutën e Lushnjës, kjo solli edhe komplikime të shpeshta, siç ishte kriza kushtetuese e dhjetorit.*” Ndërsa, duke folur për pasojat e krizës së dhjetorit, Komisioni, veçonte pikërisht dobësimin e Këshillit të Lartë: “*Në këto momente fuqia e Regjencës është fiktive, i vetmi autoritet real është në duart e Qeverisë, e cila nga ana e saj, varet nga një dhomë e zgjedhur me votim indirekt.*”<sup>22</sup> Ashtu si diplomatët britanikë edhe Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve vinte në pikëpyetje edhe

<sup>19</sup> *Po aty.*

<sup>20</sup> *Po aty.*

<sup>21</sup> *Po aty.*

<sup>22</sup> *Po aty*, FO 371/7329, f. 285-293, Raporti i përgjithshëm i Komisionit të Hetimit të Lidhjes së Kombeve, 12 prill 1922.

sistemin politik të adaptuar në vend, duke pohuar se: “në një vend ku mungon shtypi dhe ku pjesa më e madhe e zgjedhësve janë analfabetë, zgjedhjet gjithmonë do të varen nga një numër i vogël personash me influencë. Në përputhje me rrethanat, luftërat politike janë gjithmonë rivalitete personale, të cilat, për shkak të traditës dhe karakterit të shqiptarëve, shkojnë gjithmonë drejt degjenerimit në konflikte me armë. Fuqia e politikanëve matet më pak nga numri i zgjedhësve, sesa nga numri i personave të armatosur, në dispozicion të tij”.<sup>23</sup> Në këtë raport, Komisioni, ashtu si dhe përfaqësuesi britanik Smith, konfirmonte rolin e Zogut në shtypjen e grushtit të shtetit. Ai shkruante: “Në këto momente shfaqet Ahmet Beu, një kryetar i ri nën 30 vjeç, që posedonte influencë të madhe në vend, sidomos në veri dhe që dukej e sigurt që do të kishte një rol kryesor në të ardhmen e Shqipërisë. Ardhja e tij, së bashku me mijëra pasues, e detyroi Hasan Prishtinën, që ishte në fuqi prej tre ditësh, të largohet.”<sup>24</sup>

Përshtypjen negative që bëri grushti i shtetit në qarqet ndërkombëtare, e përshkruante me nota të forta edhe legata shqiptare në Romë. Ndër të tjera, në një raport të saj thuhej: “Këto ndryshime qeverish, të komunikuar në shtyp prej gazetave franceze, duke e paraqitur Shqipërinë në anarshi dhe luftë vllazënore, kanë bërë përshtypjen më të keqe, kaqë në shtyp sa dhe në qarqet politike e qeveritare të këtushëm. Kundërshtarët dhe armiqt doemos nuk presin tjetër, veç se si të gjejnë shkaqe për me na skreditimue (diskredituar) e me na kallzue si një komb i pa arrirë për vetqeverrim”. Ajo njoftonte se edhe legatat e huaja, ishin të të njëjtit mendim dhe se ardhja e H. Prishtinës në pushtet nuk ishte pritur mirë prej tyre.<sup>25</sup>

### **Kryengritja e Marsit 1922**

Ndryshimi i madh politik, që ndodhi pas grushtit të shtetit 1921, do të ndikonte për të çuar një hap përpara procesin e stabilizimit të shtetit shqiptar. Por aksioni i dhunshëm i opozitës nuk do të ndalej këtu. Në fund të shkurtit, Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve konstatoi se,

<sup>23</sup> *Po aty.*

<sup>24</sup> *Po aty.*

<sup>25</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), V. 1921, D. 3, fl.60-61, Përshtypje e legatës shqiptare në Romë mbi situatën e Shqipërisë, mbi kabinetin e Hasan Prishtinës, i Ngarkuari me Punë ad interim, T. Mborja, dt. 16.12.1921.

opozita kishte vendosur të reagonte me forcë, kundër masave stabilizuese që ndërmoi qeveria, pas grushtit të shtetit. Në një raport të këtij Komisioni, në maj të vitit 1922, thuhej: “Komisioni në njoftimin e tij më 27 shkurt, tërhoqi vëmendjen mbi faktin se po rritej opozita ndaj qeverisë, politika e së cilës, me çarmatosjen me forcë të popullsisë ka sjellë fyerjen e saj dhe se një opozitë aktive po organizohej në Pukë nën drejtimin e Bajram Currit. Duket se, që në fillim të marsit, kjo lëvizje shpërtheu në provincën e Drinit, ku një numër njerëzish me influencë, nën drejtimin e Elez Isufit, planifikuan rrëzimin e qeverisë. Duket se ata nuk kanë ndjekur një qëllim politik të caktuar, por janë frymëzuar, ashtu si në lëvizje të tjera revolucionare, vetëm nga motivi i ambicieve personale.”<sup>26</sup>

Në marsin e vitit 1922, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Elez Isufi, etj., synuan ta rrëzojnë me forcë qeverinë e Tiranës, por forcat kryengritëse të Bajram Currit, s’arritën dot deri në Shkodër ku e kishin objektivin. Qeveria i shpërndau në mënyrë të pamatur trupat që kishte në dispozicion të vet dhe dërgoi kolona të veçanta kundër tri forcave kryengritëse.<sup>27</sup> Të trembur nga përparimi i shpejtë i kryengritësve, dy anëtarët e Këshillit të Lartë, kryeministri, shumica e anëtarëve të qeverisë dhe e deputetëve u larguan në drejtim të Elbasanit. Për trupat qeveritare gjendja u bë kritike. Përmbysja e qeverisë me dhunë, rrezikonte të trondiste stabilitetin politik të shtetit shqiptar dhe të inkurajonte lakmitë e shteteve fqinje ndaj Shqipërisë. Në këtë çast, arriti nga Durrësi me një automobil, ministri anglez në Shqipëri, Harry Eyres, i cili arriti ta bindte Elez Isufin të tërhiqej nga Tirana. Politika britanike e shikonte fitoren e rebelimit, si forcim i ndikimit italian në Shqipëri, për shkak të orientimit proitalian të udhëheqësve të saj. Tërheqja e Elez Isufit, u dha mundësi forcave qeveritare të shpartallonin me lehtësi Hamit Bej Toptanin. Kështu, rebelimi i armatosur u mposht.

### **Parlamenti pas Kryengritjes së Marsit 1922**

Pas shtypjes së kryengritjes u shpall shtetrrëthimi. Për të gjykuar shkaktarët, u ngrit një gjykatë ushtarake, posaçërisht për kryengritësit dhe udhëheqësit e saj. Një pjesë e krerëve u arratisën jashtë shtetit, ndërsa

<sup>26</sup> TNA, FO 371/7329, f. 380-382, Raport plotësues i Komisionit të Hetimit në Shqipëri, 13 maj 1922.

<sup>27</sup> J. Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie ...*, f. 213.

Bajram Curri dhe Hasan Prishtina qëndruan të arratisur në malësitë e prefekturës së Kosovës. Në vend u vendos rendi dhe qetësia. Kudo u vendos administrata e rregullt shtetërore, me financat, etj. Por, duhet thënë se, krijimi i një gjykate ushtarake me qëllime të posaçme, për të gjykuar ata që kishin marrë pjesë në kryengritjet e fundit, megjithëse një masë e nevojshme për të stabilizuar gjendjen e vështirë në të cilën ndodhej vendi në atë kohë, ishte një veprim antiligjor dhe jodemokratik, në pikëpamjen e mekanizmave të një shteti ligjor. Kjo gjykatë, në kundërshtim me parimet e shtetit të së drejtës, do të kishte efekt prapaveprues, pasi si objekt të punës së saj, kishte ngjarjet e ndodhura në kohë, më parë se krijimi i vetë kësaj gjykate.

Kriza dhe tensioni në Parlament ishin në nivele të larta edhe pas shtypjes së Kryengritjes së Marsit të vitit 1922. Në këtë kohë pati një debat të ashpër midis opozitës dhe shumicës, për shtyrjen e punimeve të parlamentit për në muajin shtator.<sup>28</sup> Funksionimi i Parlamentit me periudha të gjata ndërprerjesh, ishte një tregues tjetër i krizës së sistemit parlamentar në Shqipëri. E tillë ishte edhe shtyrja e punimeve të këtij organi të lartë shtetëror, nga prilli deri në shtator të vitit 1922. Në prill të atij viti, Kryeministri Xhafer Ypi, njoftonte përfaqësitë e huaja mbi hapjen e punimeve të Parlamentit dhe në të njëjtën kohë edhe për shtyrjen e tyre deri në vjeshtë të atij viti.<sup>29</sup> Këtë fakt e pohonte edhe shtypi, i cili konstatonte se, “Këshilli Kombtar kur vendosi pushimin e fundit, kishte caktuar kohën e mbledhjes së vet më 1 Maj 1922. Por duke ndodhur revolucionin i fundit, deputetët që ndodhen në Shqipëri, numri i të cilëve shkonte në 43 vetë për veç Ministrave, në një marrëveshje që bënë në mes të tyre, kundra katër vetve, vendosën që mbledhja e Këshillit të shtyhet gjerë më 1 Shtator 1922, me qëllim që të lejnë të lirë Qeverinë të kryejë operacionin plotësisht dhe të pregatisë projektet e koncesioneve kështu që, kur të mblidhet këshilli më 1 Shtator, të jenë gati e vetëm për tu votuar”.<sup>30</sup> Në fakt, një nga shkaqet e shtyrjes së punimeve, ishte objektiv dhe kjo ishte kryengritja e marsit 1922, por, kjo sigurisht, nuk e justifikonte mungesën e aktivitetit të parlamentit për një kohë kaq të

<sup>28</sup> BKK, Viti II, 1922, Nr. 1, f. 2-29.

<sup>29</sup> AMPJ, D. 1, V. 1922, Shkëmbime telegramesh midis MPJ me përfaqësinë tonë në Paris mbi fillimin e punimeve në parlament, Kryeministri Xh. Ypi, Tiranë, më 19-IV-1922.

<sup>30</sup> *Dit' e re-Fletorja Zyrtare*, nr. 4, dt. 21 prill 1922, Eshref Frashëri, “Këshilli Kombtar, kur do të mblidhet”.

gjatë. Ndërsa argumenti i dytë, që t'i lihej kohë qeverisë për përgatitjen e koncesioneve ishte tërësisht i pajustificueshëm.

Në pranverën e vitit 1922 u zhvillua një debat i ashpër politik në parlament rreth kohës së mbledhjes së Asamblesë Kushtetuese. Përballë argumenteve të opozitës, që kërkonte mbledhjen e menjëhershme të Asamblesë Kushtetuese dhe përcaktimin e formës së regjimit, qëndronte mazhoranca, e cila, kishte parashtruar qëndrimet e saj për një shtyrje të Asamblesë për një periudhë relativisht të shkurtër. Teki Selenica ka shkruar se, Statuti i Lushnjës mbledhjen e Asamblesë e kishte lënë pas caktimit të kufijve politikë të Shqipërisë.<sup>31</sup> Ashtu siç kishte bërë shumica në debatet parlamentare, ai atakonte edhe kryengritjen e marsit, e cila ishte justifikuar nga opozita, si një kryengritje e nxitur nga nevoja e mbledhjes urgjente të Asamblesë Kushtetuese. “Për të vuë themelet e jetës politike të një shteti nuk mund të bahet assambleja nën grykën e pushkës e nën grushtin e influencën e disa vetave”, shkruante Selenica.<sup>32</sup>

Thirrjen e Asamblesë Kushtetuese, pas caktimit përfundimtar të kufijve, e mbështesnin pak a shumë edhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë. Në prill të vitit 1922, nën titullin, “*Problemi konstitucional*”, Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve, raportonte: “Në radhë të parë, duhet të themelohet një politikë e brendshme e qëndrueshme. Kur kufijtë të jenë përcaktuar, nuk do të ketë më pengesa për mbledhjen e Asamblesë Kushtetuese Nacionale, e cila do të vendosë mbi formën përfundimtare të qeverisjes në vend. Detyra e Asamblesë Kushtetuese do të jetë tepër e vështirë dhe ka mundësi që një zgjidhje efektive të mos gjendet menjëherë. Rezultati do të jetë një periudhë e papërcaktuar destabiliteti, përgjatë së cilës, vështirësitë brenda vendit mund të rriten dhe mund të sjellin edhe rrezikun e komplikimeve jashtë tij”.<sup>33</sup> Komisioni shprehte mendimin se, kjo periudhë tranzitore do të ishte periudha më kritike për Shqipërinë, kështu do të ishte e nevojshme mbajtja e disa organizatave në vend me qëllim vëzhgimin, siç ishte Komisioni i Hetimit, i cili me prezencën e tij, në të shumtën e rasteve kishte ushtruar një ndikim për t’u përsëndetur.<sup>34</sup>

<sup>31</sup> *Po aty*, nr. 8, dt. 17 maj 1922, Teki Selenica, “Statut dhe Asamble Konstituante III”.

<sup>32</sup> *Po aty*, nr. 9, dt. 24 maj 1922, Teki Selenica, “Statut dhe Asamble Konstituante IV”.

<sup>33</sup> TNA, FO 371/7329, f. 285-293, Raporti i përgjithshëm i Komisionit të Hetimit të Lidhjes së Kombeve, 12 prill 1922.

<sup>34</sup> *Po aty*.

Pas gjithë këtyre debateve që u bënë në Parlament, shumica e tij vendosi që, deri sa të mbledhesh Asambleja Kushtetuese, duheshin zgjeruar bazat e Statutit të Lushnjës.

### **Kryengritja antiqeveritare e Marsit 1922 në historiografi**

Historiografia e mëparshme por, edhe disa historianë sot, e kanë paraqitur në dritë të shtrembër kryengritjen antiqeveritare të marsit, duke injoruar tërësisht karakterin antikushtetues dhe pasojat negative që kishte ajo për institucionet dhe stabilitetin e vendit.

Vlerësime diametralisht të kundërta kanë bërë historianë dhe politikanë të asaj periudhe, të cilët, e kanë cilësuar kryengritjen, si një rebelim kundër një qeverie legjitime parlamentare dhe me pasoja të rënda për stabilitetin e vendit, ndërsa kërkesën për thirrjen e Asamblesë Kushtetuese, si një pretekst të paarsyeshëm për të justifikuar kryengritjen e armatosur.<sup>35</sup>

Kjo kryengritje është trajtuar në mënyrë tendencioze nga një pjesë e madhe e historiografisë shqiptare, duke u paraqitur si një lëvizje demokratike e drejtuar kundër klikës së Zogut dhe forcimit të pozitive të tij autoritariste. Është paraqitur si një argument justifikues për kryengritjen, çarmatimi i popullsisë që filloi qeveria, duke e vlerësuar atë si një masë antipopullore, që dëmtonte interesat kombëtarë.<sup>36</sup>

Edhe historiani Arben Puto e ka paraqitur në një dritë krejt të njëanshme dhe tendencioze, këtë kryengritje. Sipas tij, “Shtyrja e zgjedhjeve të Asamblesë Kushtetuese çoi në një rikthim të “Bashkimit të Shenjtë”. Qëllimi tani ishte që të mos lejohej vendosja e diktaturës së një oligarkie apo një personi.”<sup>37</sup> Në fakt, justifikimi i rebelimit të armatosur kundër shtetit dhe shkatërrimi i stabilitetit politik të vendit, në një kohë kaq kritike, nuk mund të justifikohet me argumentin shumë të dobët se Curri dhe opozita po luftonin kundër tendencave autoritariste të Zogut. Zogu në këtë kohë, ishte ministër i një qeverie të votuar nga një shumicë parlamentare dhe së paku nuk mund të akuzohej për veprime antiligjore. Por kjo nuk ishte e vetmja arsye, thekson Puto. “Ishte edhe një valë e re e

<sup>35</sup> Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942*, Përgatitur për botim nga Marenglen Verli, Tiranë: Neraida, 2000, f. 272-281; Teki Selenica, *Shqipëria më 1927*, Shtypshkronja Tirana, 1928, f. 95-96.

<sup>36</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, v. III..., f. 184-186.

<sup>37</sup> Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, f. 324.

tendencave ‘irredentiste’. Bajram Curri, Hasan Prishtina, Hoxhë Kadriu luajtën një rol të rëndësishëm në rimëkëmbjen e shtetit shqiptar pas lufte. Edhe pse e ndjenin se perspektivat ishin të errëta, ata nuk mund ta braktisnin popullin e tyre. Si kundërshtar kryesor të lëvizjes së tyre ata njihnin Zogun, i cili bashkë me krerë të jugut (sidomos Eshref Frashëri) mendonte se Shqipëria, së pari, duhej të konsolidohej si shtet, prandaj nuk mund të ndërmerre një politikë irredentiste.”<sup>38</sup> Në fakt, Puto qëllimisht nuk bën për këtë çështje asnjë koment, megjithëse, kushdo e kupton qartë se, një politikë irredentiste aktive dhe aq më tepër konfrontuese me Jugosllavinë në atë kohë, ishte jo vetëm e pamundur, por edhe e rrezikshme. Dhe nuk ishte vetëm Zogu që e kishte këtë pikëpamje realiste, por e gjithë mazhoranca e kohës. Madje, shumë shpejt koha do të provonte se edhe vetë opozita kur erdhi në pushtet, pas ngjarjeve të qershorit 1924, nuk mundi të bënte diçka më tepër për Kosovën.

Ndërsa autori i njohur, Robert Austin ka dhënë një shpjegim disi të ndryshëm për kryengritjen e marsit 1922. Sipas tij, “edhe pse çarmatimi përbënte një veprim të dobishëm dhe të domosdoshëm, programi i Zogut ishte seleksionues, sepse i lejoi mbështetësit e tij në Mat të lëviznin të armatosur kundër armiqve tradicionalë brenda dhe rreth Shkodrës si dhe u përqendrua në radhët e anëtarëve të “Komitetit të Kosovës”. Veprimtaria e Zogut, provokoi një kryengritje të armatosur nga disa fise veriore të udhëhequr nga Bajram Curri dhe Elez Isufi”.<sup>39</sup>

### **Kryengritja antiqeveritare e Marsit 1922 nën optikën e organizmave ndërkombëtarë**

Në opinionet e tij për gjendjen politike në vend, në marsin e vitit 1922, ministri britanik Harry Eyres, jo vetëm që pohonte ndërhyrjen për frenimin e kryengritjes, por, na jep edhe një informacion interesant për motivet e opozicionit të Elez Isufit. Ai njoftonte Londrën: “Ndërsa, qeveria po rriste fuqimisht forcat e saj, unë pata një bisedë me Elez Isufin dhe ai ishte gati të pranonte marrëveshjen. Ai mohoi çdo lloj bashkëpunimi me çdo person tjetër dhe tha se kishte vepruar nga inati, ngaqë qeveria nuk i kishte paguar shtesat që ai kishte fituar nga ruajtja e

<sup>38</sup> *Po aty*, f. 325.

<sup>39</sup> Robert C. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit*, Tiranë: Albin, 2003, f. 64.

kufirit, gjatë vitit që kaloi”.<sup>40</sup> Gjithashtu, Eyres jep edhe një informacion interesant mbi arsyet e kësaj ndërhyrjeje që ai kishte bërë për të shmangur konfliktin midis Elezit dhe qeverisë, duke bërë edhe një lloj autokritike, për faktin se kishte vepruar pa udhëzimet e Foreign Office, për arsye të situatës kritike që ishte krijuar. “Shpresoj se Zotëria juaj nuk do të mendojë se i kam kaluar kompetencat e mia në këtë rast, theksonte Eyres. Shqipëria nuk është si vendet e tjera, unë isha i vetmi person në vend, të cilit të dy palët do t’i besonin. E mendova si të drejtë t’i jepja mbështetjen time Qeverisë, tek e cila jam akredituar, dhe gjithashtu të parandaloja, nëse ishte e mundur, gjakderdhjen dhe shkatërrimin e një pjese të madhe të qytetit. Isha tepër me fat që pata sukses, dhe Qeveria e populli i Tiranës më shprehën mirënjohjen.”<sup>41</sup>

Por, menjëherë pas kësaj deklarate të Eyres, vijonte një informacion tjetër tepër interesant dhe konfidencial i tij, mbi ndërhyrjen e huaj në mbështetje të segmenteve të caktuara të opozitës shqiptare. Ai informonte Londrën: “Ju kam dhënë deri tani aspektin sipërfaqësor të çështjes, por çështja interesante, se të cilit ishin lëvizjet e para, është për t’u zgjidhur. Qeveria dhe njerëzit e ndryshëm në rrugë, janë vendosmërisht të bindur se Italia është shtytësja dhe mbështetësja e komplotit. Ato pranojnë se nuk kanë prova dokumentare për t’i vënë këto akuza në letër, por thonë se Bajram Curri është mik i ngushtë i Italisë, Hasan Bej Prishtina, gjithashtu, dhe se ato nuk kishin burimet e nevojshme për të organizuar një kryengritje kaq të zgjeruar.”<sup>42</sup> Ndërhyrjen italiane e raportonte edhe përfaqësuesi britanik në Komisionin e Kufijve, i cili pohonte: “Shkodra ishte e privuar nga të gjitha komunikimet me anë të tokës me Shqipërinë e jugut. Përgjatë javës së dytë të marsit, pati tentativë për revolucion nga italo-filët e pakënaqur nga qeveria e fundit, të cilët u financuan me fonde italiane.”<sup>43</sup>

Pas shtypjes së revoltës, Eyres raportonte se, qeveria e kishte rritur dukshëm prestigjin e saj në vend, për shkak të rezistencës së suksesshme ndaj forcave përçarëse. Ai paralajmëronte se, “në kundërshtim me këtë

<sup>40</sup> TNA, FO 371/7331, f. 427-429, Telegram i Eyres mbi ngjarjet e marsit 1922, Durrës, 16 mars 1922.

<sup>41</sup> *Po aty*.

<sup>42</sup> *Po aty*.

<sup>43</sup> *Po aty*, FO 371/7330, f. 689-696, Ngjarjet nga 1 mars-31 mars 1922, Raport i komisionerit britanik Hiles në Komisionin e Kufijve Serbo-Shqiptare, mbi tentativën për grusht shteti në Shqipëri.

nuk mund të shpresohet se kontrolli i vrazhdë i zbatuar ndaj komplotistëve, do të sjellë paqen në vend për një kohë të gjatë.” Eyres vlerësonte me superlativa A. Zogun për qëndrimin që mbajti gjatë krizës. “Nuk ka dyshim se Ahmet Zogu, Ministri i Punëve të Brendshme, ishte heroi i krizës. Pa të, qeveria do të kishte degraduar. Jam habitur me energjinë dhe kapacitetin e tij dhe tashmë ndihem më me shpresë për të ardhmen, që prej ‘coup d’etat’ të Aqif Pashës.”<sup>44</sup> Të njëjtën gjë raportonte edhe diplomati britanik, Smith, i cili parashikonte përsëritjen e trazirave në të ardhmen. Smith nënvizonte në këtë rast, domosdoshmërinë e thirrjes urgjente të Asamblesë Kushtetuese si dhe rreziqet që vinin nga shtyrja e saj. Ai informonte Lordin Curzon, se kabineti i zgjedhur më 25 dhjetor dhe i drejtuar nga Xhafer Ypi, ishte i vendosur të mos thirri Asamblenë Kushtetuese, derisa të përcaktoheshin kufijtë. Për pasojë, çështja e fuqisë sovrane në të ardhmen do të mbetej pezull. Linja e dytë e stabilizimit të shtetit, nënvizonte Smith, ishte krijimi i një autoriteti të fortë, me të cilin ai nënkuptonte, vendosjen e një monarku me pushtet të gjerë. “Ndërmjet të gjithë shqiptarëve, shkruante ai, është kuptuar se, që këtu të mbizotërojë paqja e brendshme, një autoritet i fortë dhe i respektueshëm duhet të vendoset ose të pranohet vullnetarisht nga vendi. Vonesat e mëtejshme në pranimin e kësaj çështjeje fundamentale, shihen si vazhdim i një periudhe pasigurie dhe trazirash. Ka mundësi që do të jetë thirrja e Asamblesë Kushtetuese dhe vendosja e Monarkisë, ajo që do të bashkojë ato që organizuan lëvizjet e kaluara politike në vend”<sup>45</sup>.

Si përfundim, mund të themi se, sistemi demokratik i vendosur nga Kongresi i Lushnjes, po rezultonte joefektiv. Ai nuk solli stabilitet politik dhe ekonomik në vend, por përkundrazi, solli destabilitet, derisa e çoi shtetin në shkatërrim, për shkak të grushteve të shtetit dhe kryengritjeve të shumta, që karakterizuan këtë periudhë. Shihet se kjo formë qeverisjeje dhe e formatimit të institucioneve kombëtare, nuk i përshtatej mundësive reale, që kishte kombi shqiptar në atë kohë. Për këtë arsye, ajo, jo vetëm që dështoi, por, ishte edhe një nga faktorët që prodhoi destabilitet dhe kriza të rënda e të rrezikshme, për vetë ekzistencën e shtetit shqiptar.

<sup>44</sup> *Po aty*, FO 371/7331, f. 441-442, Telegram i Eyres mbi ngjarjet e marsit 1922, 29 mars 1922.

<sup>45</sup> *Po aty*, FO 371/7330, f. 581-586, Telegram i Heathcote Smith për Curzon, mbi situatën politike në vend, 18 janar 1922.

*S u m m a r y*THE SITUATION IN ALBANIA AFTER THE SEVERE POLITICAL CRISIS OF 1921 AND  
THE UPRISING OF MARCH 1922

The political situation in Albania after the severe crisis of 1921 and the uprising of March 1922 was not easy at all. As a matter of fact the situation in which the representing institutions of the country were in at those moments needs to be judged carefully. These institutions lacked experience, legal tradition and institutional capacities to solve the situation in such a way that on the one hand the stability of the country be kept and on the other hand such legal measurements be taken that did not allow the repetition of similar occurrences in the future. But their soft and mild or reluctant attitude had also objective reasons. Attending a resolute policy and legal punishment of the organizers of the coup d'état was very hard. Such a policy should pass through a very difficult path where one could run pretty smoothly into a civil war which would detonate the realization process of the institutions and of the national state and it could come up to a serious jeopardy of the existence of this state itself taking into account that Albania's neighbors were there looking forward to such developments in order to make their annexation objectives come true.

Thus the moderated attitude of the state institutions toward the conspirators was a wise policy aiming at national reconciliation by the good will of tolerating the opposition and accepting the co-existence with it, bailing out in this way the parliamentary political system and leaving the way open to the development of national institutions in peace towards democracy. On the other hand this tolerant and inadequate attitude viewed in respect of law implementation as it would have been done in any other country where a more or less legal state was functioning with relatively consolidated institutions, left also the way open to the repetition of other coup d'états in the future. And to the bad luck of Albania such painful and dangerous episodes would come with no delay.

